



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 645/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Rean 95” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-67106-05-04-2018 me objekt: Loti III “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Instalim i sistemit Ujëmatës elektromagnetik në Depot e Tiranës (Faza I)”, me fond limit 1.124.013 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 30.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

Ankimues:

“Rean 95” shpk
Adresa: Rruga “Musa Karapici”, Nr 6, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a
Adresa: Rruga “5 Maj”, pranë Medreses Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili nuk e ka pranuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.05.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-67106-05-04-2018 me objekt: *Loti III “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Instalim i sistemit Ujëmatës elektromagnetik në Depot e Tiranës (Faza I)”*, me fond limit 1.124.013 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 30.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a..

II.2 . Në datën 30.05.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 06.06.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton si më poshtë vijon:

- Tower

Pa ofertë

I skualifikuar

- Rean 95	847,300	lekë	I skualifikuar
- C.E.C Group	955,000	lekë	I skualifikuar
- A&E Engineering	961,000	lekë	I skualifikuar
- IMES-D	1,003,583	lekë	I skualifikuar
- HE&SK 11 11	1,011,611	lekë	I skualifikuar
- B-VAAL Engineering	1,030,346	lekë	I skualifikuar
- Novatech Studio	1,036,041.2	lekë	I skualifikuar
- Gjeokonsult&Co	1,050,000	lekë	I skualifikuar
- GB Civil Engineering	1,057,894	lekë	I skualifikuar
- Erald – G	1,057,895	lekë	I kualifikuar
- BOE XH&MILER & A.SH Engineering	1,112,772	lekë	I kualifikuar
- Infratech	1,120,000	lekë	I kualifikuar

II.4. Në datën 06.06.2018 operatori ekonomik “Rean 95” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur elektronikisht nga Operatori Ekonomik “REAN 95” shpk, konstatoi se, Operatori Ekonomik “REAN 95” shpk, nuk plotëson, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pasi Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur nga Operatori Ekonomik është nën vlerën minimale të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor.*
- *Mbeshtetur ne VKM nr.354 date 11.05.2016 ”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe ne mbeshtetje te udhezimit te Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”. Operatori ekonomik do te skualifikohet nese ofertat e tyre do te rezultojne nen minimumin e lejuar te perlogaritur nga AK (ne baze te VKM nr.354, date 11.05.2016, ne varesi te kategorise dhe grupit tarifor ku ben pjese objekti i prokurimit). Oferta e Operatorit Ekonomik “REAN 95” shpk, rezulton nen minimumin e lejuar te perlogaritur nga Autoriteti Kontraktor, ne baze te VKM nr.354, date 11.05.2016.*
- *Bazuar në Rekomandimin e APP-së nr.5585 datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”, pika 2 shprehimisht thuhet se : “Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat mund të jenë më të ulta sesa normat minimale, të specifikuara nga ky manual”.*
- *Në rastin kur Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanën e jashtëzakonshme, Autoriteti Kontaktor gjatë vlerësimit të ofertës duhet ti referohet vlerës minimale të përlogaritur për këtë procedurë prokurimi në bazë të parashikimit në VKM nr.354 datë*

11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”.

- Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nëse ndodhet në rrethana të jashtëzakonshme për procedurën e prokurimit me objekt: Mbikqyrja e punimeve për objektin: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rikonstruksion rrjet Kanalizimi në Rrugën "Qazim Vathi“.
- Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “Rean 95, është i paplotë pasi nuk ka përmbushur VKM nr.354 date 11.05.2016 ”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.
- Operatori ekonomik do te skualifikohet nese ofertat e tyre do te rezultojne nen minimumin e lejuar te perllogaritur nga AK (ne baze te VKM nr.354, date 11.05.2016, ne varesi te kategorise dhe grupit tarifor ku ben pjese objekti i prokurimit). Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje VKM nr.354 date 11.05.2016 ”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” , e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e sa më sipër..

II.5. Në datën 12.06.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Ju bëjmë me dije se udhëzimi nr. 5585 datë 25.07.2017 i përket procedurës blerje e vogël jo Procedurë e Hapur. Autoriteti Kontraktor për ta vlerësuar tenderin duhet të botojë edhe fondin limit të investimit më qëllim që cdo operatorë të bëjë llogaritjet e tarifës. Sipas tarifave të detajuara të hartuara nga ana jonë oferta e paraqitur është e mjaftuesheme pagat që kemi, afatin 60 ditor të botuar, për të kryer shërbimin dhe nuk përbën shkak për skualifikim. Autoriteti kontraktor fillimisht nuk duhet të skualifikojë operatorët, por duhet të kërkojë sqarime për ofertën e dhënë. Veprimi i skualifikimit në sistem është diskriminues dhe ofendues për ne. Kjo për faktin se kemi mbi 22 vjet në treg, i paguajm taksat rregullisht shtetit dhe 2 tre punonjës të një autoriteti kontraktor të flakin sikur e kanë mallin e tyre tenderin.

Sa më sipër kërkojmë anulimin e vlersimit të shpallur, dhe të kualifikohet Rean 95 shpk.

II.6. Në datën 14.06.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. K-2624/1 i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik.

II.7. Në datën 25.06.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. K- 2921/1 prot., datë 04.07.2018 protokolluar me tonën me nr.1179/2 datë 05.07.2018 me objekt “*Dërgohet informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Në datën 31.08.2018, me shkresën nr. 1179/3 prot., Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar dokumentacion në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.10. Me shkresën nr. K-2921/3 prot, datë 03.09.2018 protokolluar me tonën me nr 1179/4 prot. Datë 04.09.2018, si dhe me shkresën nr K-2921/4 prot, datë 03.09.2018 protokolluar me tonën me nr 1179/5 prot. Datë 27.09.2018, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Rean 95*” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Autoriteti Kontraktor për ta vlerësuar tenderin duhet të botojë edhe fondin limit të investimit më qëllim që cdo operatorë të bëjë llogaritjet e tarifës. Sipas tarifave të detajuara të hartuara nga ana jonë oferta e paraqitur është e mjaftueshme pagat që kemi, afatin 60 ditor të botuar, për të kryer shërbimin dhe nuk përbën shkak për skualifikim. Autoriteti kontraktor fillimisht nuk duhet të skualifikojë operatorët, por duhet të kërkojë sqarime për ofertën e dhënë. Veprimi i skualifikimit në sistem është diskriminues dhe ofendues për ne. Kjo për faktin se kemi mbi 22 vjet në treg, i paguajm taksat rregullisht shtetit dhe 2 tre punonjës të një autoriteti kontraktor të flakin sikur e kanë mallin e tyre tenderin. Sa më sipër kërkojmë anulimin e vlersimit të shpallur, dhe të kualifikohet Rean 95 shpk.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr. K-2921/3 prot, datë 03.09.2018 protokolluar me tonën me nr 1179/4 prot. Datë 04.09.2018, si dhe me shkresën nr K-2921/4 prot, datë 03.09.2018 protokolluar me tonën me nr 1179/5 prot. Datë 27.09.2018, KPP konstaton se përlllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga ky i fundit është bërë, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”.

III.1.3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” sipërcituar në nenin 1 të tij “Fusha e Veprimt” parashikon shprehimisht se: *Ky manual i tarifave vlen për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e palnifikimit, projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët (porosimarrës) të financuara me fonde publike, të financuara me fonde publike, të përfshira në listën e punimeve të këtij manuali.*

Ndërsa në nenin 7 të saj parashikohet shprehimisht se: *Tarifat për shërbimet duhet të jenë në një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale të përcaktuara në këtë manual në përputhje me LPP. Pika 3 e nenit 7 parashikon se: Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim tarifat edhe mund të jenë më të ulëta se sa taifa minimale të specifikuar nga ky manual.*

III.1.4. Në Rekomandimin Nr. 5585 Prot datë 25.07.2017 të APP-së; “Rekomandim mbi menyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, parashikohet si më poshtë:

- *Per shërbimet e parashikuara në vendimin e sipërcituar (Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016), APP rekomandon që, krahas përlllogaritjes së fondit limit (i cili përlllogaritet nisur nga përqindja maksimale e lejuar), bëhet përlllogaritja e vlerës minimale të lejuar (e cila përlllogaritet nisur nga përqindja minimale e lejuar), në varesi të kategorisë dhe grupit tarifor, ku bëhet pjesë objekti i prokurimit*
- *Në nenin 7, pika 3, të vendimit të sipërcituar, parashikohet se: "Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat edhe mund të jenë më të ulëta se sa normat minimale, të specifikuar nga ky manual".*
- *Në këtë kontekst rekomandojmë që, në rastet kur nuk dokumentohet rrethana e jashtëzakonshme, autoritetet kontraktore gjatë vlerësimit të ofertave, duhet t'i referohen vlerës minimale të përlllogaritura për secilin rast, në bazë të parashikimeve në VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim".*
- *Në paraqitjen e ofertave në këtë lloj procedure prokurimi, operatorët ekonomikë duhet të mbajnë në konsideratë edhe vlerat minimale të përlllogaritura nga autoritetet kontraktore në zbatim të VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim".*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, në rastin konkret, nisur nga informacioni dhe dokumentacioni i detajuar i dhënë nga autoriteti kontraktor, kryesisht në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, konstaton se, nga ky i fundit janë bërë përlllogaritjet edhe për përcaktimin e vlerave minimale e maksimale të mbikëqyrjes, duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Pra vetë autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për

zhvillimin e procedurës së prokurimit ka përcaktuar detaje për përcaktimin e fondit limit, të cilat vinë në përmbushje të legjislacionit përkatës në fuqi.

Qëllimi i VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*” është që të mbrojë profesionet të cilat merren me planifikim territori, projektim, mbikëqyrje e kolaudim, pra lidhet me punën intelektuale që do të bëhen, duke dhënë një punë cilësore, por me një vlerë mbi minimumin e lejuar të përcaktuar me një vendim të posaçëm.

Kjo VKM e posaçme ka për qëllim të zgjidhë situatën e vështirë të krijuar në afrimin dhe përzgjedhjen e personave fizikë, apo juridikë të interesuar, të kontraktohen për shërbimet e kërkuara, pasi shpesh ka rezultuar edhe me uljen e cilësisë së shërbimit të ofruar.

Efekti i zbatimit të kësaj VKM është rritja e cilësisë së produktit të marrë në fushën e studimit, projektimit, drejtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, nëpërmjet afrimit të profesionistëve të dalluar, duke përafruar nivelin e pagave që ato t’i përgjigjen realitetit të tregut të sotëm.

Gjithashtu, referuar edhe frymës së legjislacionit të posaccëm në fuqi, në rast se nuk zbatohet kjo VKM e cila ka dalë për qëllim të posaçëm për të mbrojtur punën intelektuale që bëhet në fushën e këtyre shërbimeve, atëherë kjo VKM nuk ka më asnjë vlerë dhe do të humbiste qëllimin për të cilin ka dalë për zbatim, sepse vetëm nëse do të mbeteshim tek argumentimi i analizës së kostos nëse ajo do të rezultonte anomalisht e ulët, atëherë kjo analizë do të ishte shumë subjektive, aq më tepër kur autoriteti kontraktor mund të kërkonte sqarime nga operatorët ekonomikë nëse pas aplikimit të formulës për ofertën anomalisht të ulët, mbi ofertat brenda kufijve ligjorë, do të rezultonte se një apo më shumë oferta janë anomalisht të ulta.

Autoriteti kontraktor sqaron se ai që në përllogaritjen e fondit limit ka përcaktuar edhe vlerën minimale nën të cilën çdo operator ekonomik do të skualifikohej për ofertë të papërgjegjshme dhe jo në përputhje me përcaktimet e posaçme ligjore në fuqi dhe në rastin konkret, kur ekziston një bazë ligjore e posaçme që rregullon vlerat minimale, çdo autoritet është i detyruar ta ketë parasysh gjatë vlerësimit të ofertave dhe ta zbatojë atë me përpikmëri.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, vlerësimi i ofertave është kryer duke mos aplikuar formulën për ofertën anomalisht të ulët referuar ligjit për prokurimin publik, por i është referuar vlerave minimale, pasi shoqëria ankimuese ka paraqitur një ofertë të papërgjegjshme dhe nën kufirin e përcaktuar nga legjislacioni i posaçëm në fuqi “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”, e cila është e detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë, pasi ky legjislacion nuk lë në diskrecionin e një autoriteti kontraktor të pranojë argumentat për elementët e veçantë të ofertës ekonomike të operatorëve, përsa kohë që ajo është jashtë kufijve minimalë dhe maksimalë të tarifave.

III.1.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se vlera minimale e mbikëqyrjes e përllogaritur për objektin “*Loti III “Mbikëqyrja e punimeve për objektin: “Instalim i sistemit Ujëmatës elektromagnetik në Depot e Tiranës (Faza I)”*”, është në vlerën 1,057.894 (një milion e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit “ofertës ekonomike” të operatorit ekonomik “*Rean 95*” shpk,

rezulton se vlera e ofertuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi është 847,300 lekë pa tvsh. KPP gjykon se vlera e ofertuar nga operatori ekonomik ankimues nuk është në përputhje me VKM nr. Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, dhe rekomandimin e APP-së, pasi është më e ulët se vlera minimale e përlogaritur nga autoriteti kontraktor për realizimin e kësaj kontrate.

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP gjykon se duke qenë se kuadri ligjor në fuqi ka vendosur tarifa minimale dhe maksimale për shërbimet e mbikëqyrjes dhe kolaudimit duhet të mbahen në konsideratë nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këto procedura.

Në këtë kuptim, Komisioni sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë të garantojnë që oferta e paraqitur të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, operatori ekonomik ankimues, “Rean 95” shpk, ka ofertuar me një vlerë e cila rezulton të jetë nën vlerën minimale të lejuar të përlogaritur nga autoriteti kontraktor për kryerjen e këtij shërbimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rean 95” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-67106-05-04-2018 me objekt: Loti III “Mbikëqyrja e punimeve për objektin: “Instalim i sistemit Ujëmatës elektromagnetik në Depot e Tiranës (Faza I)”, me fond limit 1.124.013 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 30.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1179 Protokoli, Datë 25.06.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha